



**PARANDALIM I DHUNËS NDAJ GRAVE
PARA SE AJO TË NDODHË**

**MOS HESHT!
NGRIJE ZËRIN!**







**PARANDALIM I DHUNËS NDAJ GRAVE
PARA SE AJO TË NDODHË**

**MOS HESHT!
NGRIJE ZËRIN!**

Refleksione 2020

Broshura “ Mos hesht! Ngrije zërin!” botohet në kuadër të projektit, “Parandalim i dhunës ndaj grave, para se ajo të ndodhë”, të mbështetur nga Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë, Tiranë, zbatuar nga “Refleksione” në partneritet me Qendrën për Vlerësim, Menaxhim dhe Treinim, (Center for Evaluation, Managing and Training, CEMT) në 12 bashki: Berat, Elbasan, Fier, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Pogradec, Kavajë, Korçë, Roskovec, Shkodër dhe Vlorë.

Parandalimi i Dhunës kundër Grave dhe Vajzave, (DHKGV) para se ajo të ndodhë, njihet ndryshe edhe si Parandalim Parësor, pasi synon ta ndalojë dhunën para se ajo të shfaqet. Në qendër të parandalimit parësor janë nisma për transformimin e mentalitetit, dhe stereotipeve gjinore, që ushqejnë pabarazinë mes burrit dhe gruas dhe inkurajojnë dhunën ndaj grave. Transformimi i mentalitetit është një proces që kërkon kohë dhe ndërhyrje të kombinuara në disa drejtime, një prej të cilave është edhe angazhimi i shoqërisë civile dhe në këtë kontekst i “Refleksioneve” në bashkëpunim me pushtetin dhe aktorët lokalë.

Rritja e ndërgjegjësimit në komunitetet e grave dhe vajzave për të ngritur zërin kundër dhunës, njohur ligjet për ta luftuar atë ligjërisht, roli i medias lokale në kundërshtimin e stereotipeve gjinore dhe justifikimin e dhunës, nevoja për aleancë mes aktorëve lokalë në parandalimin e dhunës janë në qendër të kësaj broshure.

Realizuan botimin:

Ani Ruci

Daniela Kalaja

Fabjola Zoto

Shtypur në Shtypshkronjën

Kjo broshurë është on line në:

Drejtores e projekti

Prof. Dr. Eksperte Gjinore

Kopertina, Layout

“Lilo”

www.refleksione.org

PARATHËNIE

Ne besojmë që DHKGV mund të parandalohet. Ne besojmë që, të gjithë së bashku, mund të sjellim në Shqipëri atë ndryshim shoqëror ku gratë dhe vajzat të jetojnë të çliruara nga frika e dhunës, të respektuara, të vlerësuara dhe të trajtuara të barabarta me burrat në jetën publike dhe private.

Me këtë besim, “Refleksione” publikon broshurën “Mos hesht! Ngrije zërin! Parandalim i dhunës ndaj grave para se ajo të ndodhë,” si kontribut drejt këtij ndryshimi. Broshura u drejtohet komuniteteve të grave dhe vajzave, në zonat urbane dhe rurale, autoriteteve lokale, anëtarë të Mekanizmit të Koordinuar të Referrimit, (MKR) për adresimin e rasteve të dhunës në 12 bashki por edhe në gjithë bashkitë e tjera të vendit si edhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Përkrahjes Sociale.

DHKGV mbetet shqetësuese dhe një nga format më të përhapura të dhunës në Shqipëri. Refleksione dhe partnerja e saj CEMT synojnë të kontribuojnë në ndryshimin e kësaj situatë. Ne synojmë të rrisim ndërgjegjësimin të grave, vajzave dhe aktorëve lokalë që dhuna është një çështje serioze publike, një krim, në kundërshtim me ligjin dhe si e tillë dënohet. Ne synojmë të përcjellim besimin se DHKGV është e parandalueshme.

Refleksionet falenderojnë përzemërsisht dhe i shprehin mirënjohjen Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë, Tiranë, që mbështeti financiarisht zbatimin e projektit “Parandalim i dhunës ndaj grave para se ajo të ndodhë,” dhe bëri të mundur botimin e kësaj brochure.

Ani Ruci

Drejtoreshë Ekzekutive
Refleksione

LISTA E AKRONIMEVE

BE	Bashkimi European
CEMT	Center for Evaluation, Managing and Training
DHF	Dhuna në Familje
DHKGV	Dhuna Kundër Grave dhe Vajzave
INSTAT	Instituti i Statistikave
KD	Komiteti Drejtues
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referrimit për rastet e dhunës
UN Women	Enti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave
UN Trust Fund	Fondi i Mirëbesimit të Kombeve të Bashkuara
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

ANNEX 1

Bashkia	Emri i koordinatorës ne bashki	Nr. i tel.	Policia
Berat	Fabiola Meço	064747347	129
Elbasan	Marsida Sejdi	0697610791	129
Fier	Natasha Sollaku	0693648824	129
Lezhë	Afërdita Gjoni	0676099144	129
Lushnjë	Juliana Pirra	0694883933	129
Përmet	Arjana Papapano	0692288617	129
Pogradec	Arbri Basho	0673810099	129
Kavajë	Medina Papoj	0692192342	129
Korçë	Inelda Hasankolli	0692753289	129
Roskovec	Nertila Pelivani	0682314530	129
Shkodër	Filip Vila	0682027308	129
Vlorë	Fabiola Islami	0692128127	129

PABARAZIA GJINORE - SHKAK DHE PASOJË E DHUNËS

DHKGV është një sjellje abuzive e burrave ndaj grave dhe vajzave thjesht për shkak të gjinisë së tyre. Ajo është një nga rastet më të rënda të shkeljes së të drejtave të njeriut, një dukuri që prek gratë dhe vajzat pavarësisht nga arsimimi dhe statusi i tyre ekonomik - social.

DHKGV buron nga pabarazia sistematike dhe e rrënjosur thellë mes grave dhe burrave dhe është njëherazi shkak dhe pasojë e pabarazisë gjinore.

Indeksi i Barazisë Gjinore në Shqipëri, i publikuar ng INSTAT në janar 2020, është 60,4 pikë ose 7 pikë më i ulët se mesatarja e vendeve anëtare të BE, pozicion që tregon se Shqipëria ka ende shumë për të bërë që të arrijë barazinë e plotë gjinore mes burrave dhe grave. Edhe pse është arritur përparim domethënës drejt barazisë gjinore, stereotipet për rolin e burrit dhe gruas në jetën publike dhe private janë ende të fuqishme, diskriminimi në bazë të gjinisë ende ndodh në shumë kontekste.

Kjo situatë kufizon aftësinë e grave dhe vajzave për të marrë pjesë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë në shoqëri, kufizojnë qasjen e tyre në pozicione vendim - marrëse dhe në burime ekonomike. Nga ana tjetër, burrat priren të gëzojnë privilegje, të mundësuar nga qasja e tyre më e madhe në pushtet dhe vendim-marrje, në burime ekonomike dhe materiale por edhe nga mundësitë për zhvillim dhe pavarësi, si në jetën publike ashtu edhe në atë private.

Promovimi i barazisë gjinore është komponent shumë i rëndësishëm i Parandalimit Parësor të DHKGV. Pabarazia gjinore rrit rrezikun e dhunës se burrave kundër grave dhe në të njëjtën kohë frenon aftësinë e grave që pësojnë dhunë të largohen nga situata abuzive ose të kërkojnë mbrojtje.

ÇFARË ËSHTË PARANDALIMI PARËSOR?

Broshura “Mos hesht” Ngrije zërin! Parandalim i dhunës ndaj grave para se ajo të ndodhë!” kundërshton idenë që dhuna është e pashmangshme ose e pranueshme. Kjo përjasje është në themel të ndërhyrjeve të Parandalimit Parësor, që zhvillohen para se dhuna të shfaqet. Ato synojnë të ndalojnë mundësitë që burrat të përdorin dhunë ndaj grave dhe vajzave. Parandalimi parësor e bën këtë duke adresuar shkaqet thelbësore të dhunës duke marrë në konsideratë që DHKGV shkaktohet nga ndërveprimi i një sërë faktorëve individualë, shoqërorë dhe komunitarë.

Në fokus të Parandalimit Parësor është ndryshimi i qëndrimeve dhe sjelljes shoqërore, dhënia fund e tolerancës ndaj DHJGV me anë të informimit, rritjes së ndërgjegjësimit për të drejtën e tyre për një jete pa dhunë, edukimit ligjor, trajnimeve për t’u përballur me dhunën në rrugë ligjore. Me fjalë të tjera, synimi për të ndaluar DHKGV para se ajo të ndodhë kalon nga ndryshimi i sjelljeve, zakoneve, qëndrimeve dhe strukturave që mbështesin pabarazinë gjinore, tolerojnë ose minimizojnë dhunën dhe abuzimin. Parandalimi Parësor lidhet me forcimin e faktorëve mbrojtës dhe dobësimin e faktorëve që nxisin DHKGV. Përvoja ka treguar që ndryshimi i mentalitetit, në rradhë të pare i normave shoqërore të rrënjosura në komunitete për pabarazinë gjinore dhe që përjetësojnë dhunën, është thelbësor për parandalimin e saj.

Rritja e njohurive të komunitetit të grave dhe vajzave për të drejtat e tyre, njohja me legjislacionin kombëtar dhe konventat ndërkombëtare kundër dhunës, edukimi i tyre ligjor, njohja me MKR dhe shërbimet në dispozicion të viktimave të dhunës janë komponentë të rëndësishëm në ndërhyrjen e Refleksione në 12 bashki për të parandaluar DHKGV para se ajo të ndodhë.

Rritja e ndërgjegjësimit për ligjet dhe politikat për parandalimin e DHKGV ka dëshmuar të ketë sjellë rritjen e raportimeve dhe denoncimeve nga vetë grate dhe vajzat në institucionet që adresojnë në nivel lokal rastet e dhunës.

ÇËSHTJET KRYESORE QË ADRESON PARANDALIMI PARËSOR

Suksesi në Parandalimin Parësor të DHKGV lidhet me kultivimin e një qëndrimi të përgjegjshëm të shoqërisë, ku të gjithë anëtarët e saj duhet të luajnë rolin e tyre në ndryshimin e kulturës, stereotipeve gjinore dhe qëndrimeve që nxisin dhe përlligjin dhunën ndaj grave. Parandalimi parësor synon transformimin shoqëror në një nivel të tillë që ai të krijojë parakushte për një botë të sigurtë dhe të barabartë për gratë dhe vajzat.

Çështjet kryesore që adreson Parandalimi Parësor, në synimin për të ndryshuar mentalitetin, normat kulturore dhe sociale që ushqejnë dhunën janë: tolerimi dhe justifikimi i dhunës që u lejon dhunuesve të mohojnë dhunën që ushtrojnë ndaj grave dhe vajzave dhe të fajësojnë pikërisht ato, viktimat e tyre, si shkaktare të dhunës; kontrolli i burrave ndaj vendim - marrjes dhe kufizimet e pavarësisë së grave në jetën publike dhe private; stereotipet e ngurta për rolet gjinore.

Për të kontribuar në ndryshimin e dëshëruar social këto çështje adresohen duke u fokusuar në: kundërshtimin e tolerimit të dhunës ndaj grave; promovimin e pavarësisë së grave dhe vajzave në marrjen e vendimeve për vehten e tyre në jetën publike dhe atë private; nxitjen e identitetit pozitiv personal dhe kundërshtimin e stereotipeve për rolet gjinore; forcimin e marrdhënieve pozitive, të barabarta dhe të respektueshme mes grave dhe burrave, vajzave dhe djemve; promovimin e barazisë gjinore në jetën publike dhe private.

Parandalimi Parësor është ndërkohë edhe përqasja më strategjike për t'i dhënë fund DHKGV për arsye se:

- Parandalimi i dhunës është shumë më i preferueshëm sesa adresimi i saj që ka kosto dhe sjell pasoja shkatërrimtare: DHKGV cënon shëndetin, sigurinë, dinjitetin dhe lirinë e grave dhe vajzave.
- Në terma kohorë afat gjatë përpjekjet e suksesshme të Parandalimit Parësor krijojnë parakushte për përmirësimin e statusit politik, ekonomik dhe social të grave dhe vajzave.

DHKGV lidhet ngushtë, në thelb, me pozicionin e tyre politik, shoqëror dhe ekonomik. Nisur nga ky fakt, "Refleksione" i vendos ndërhyrjet për Parandalimin Parësor të DHKGV në kuadër të synimeve më të gjera për fuqizimin e tyre në këto fusha dhe forcimin e të drejtave të tyre, si të drejta themelore të njeriut.

FUQIZIMI GRUAS, KOMPONENT KYÇ NË PARANDALIMIN PARËSOR

Fuqizimi politik, ekonomik dhe social i grave dhe vajzave ka një rol thelbësor në parandalimin e dhunës ndaj tyre. Në pjesëmarrjen e gruas në politikë Shqipëria ka progres të rëndësishëm dhe renditet i pesti vend në botë që ka një qeveri me ekuilibër të lartë gjinor, ku 53,3 % e Këshillit të Ministrave, pas riorganizimit të qeverisë Rama, në vitin 2018, janë gra.

Sipas UN Women¹ në krye të listës prej 5 vendesh qëndron Spanja, e ndjekur nga Finlanda, Nikaragua, Suedia dhe në vend të pestë është

1 UN Women- Enti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave, në krye të listës është Spanja e ndjekur nga Finlanda, Nikaragua, Suedia dhe Shqipëria.

Shqipëria. Ky përfaqësim i grave në politikë është rezultat i zbatimit të ligjt për kuotën 30 % ne Qeveri dhe Parlament dhe 50% në organet e pushtetit lokal. Por përqindjet dhe numrat nuk tregojnë gjithshka: në Shqipëri politika vazhdon të jetë domen i burrave dhe në shoqërinë e saj partiarkale gratë vërtet vendosen në boshtin numerik por jo në tryezat e vendim - marrjes. Për fuqizimin ekonomik dhe social të grave dhe vajzave rëndësi prioritare ka barazia gjinore, mbrojtja e të drejtave të grave dhe vajzave dhe rritja e statusit të tyre politik, ekonomik dhe social.

Sa më të arsimuara të jenë grate dhe vajzat aq më të gatshme janë ato të kundërshtojnë normat dhe praktikat kulturore që çojnë në dhunë apo që legjitimojnë dhunën. Gratë dhe vajzat e arsimuara gëzojnë një pavarësi më të madhe në vendimmarrjen për jetën e tyre.

Rritja e aksesit në tregun e punës sfidon perceptimin ekzistues të roleve gjinore që kufizojnë pavarësinë dhe aftësinë e grave.

Fuqizimi ekonomik dhe social i grave është një komponent i rëndësishëm i Parandalimit Parësor të dhunës. Në këtë kontekst ulja e varfërisë merr një rol thelbësor në trajtimin e pabarazisë gjinore. Gratë kanë më shumë gjasa të jetojnë në varfëri sesa burrat për shkak të përqindjes më të ulët të punësimit të grave, hendekut gjinor të pagave dhe shpërndarjes së financave brenda familjes. Sipas studimit “Burrat dhe Gratë në Shqipëri, 2019” nga INSTAT, shkalla e punësimit për popullsinë nga 15-64 vjeç është 66,7 % për burrat dhe 52,4 %, pra 14 % më e ulët.²

2 Burra dhe Gra në Shqipëri, 2019, INSTAT fq 64. http://www.instat.gov.al/me-dia/6413/burra-dhe-gra_2019.pdf

MEKANIZMI I KOORDINUAR I REFERRIMIT - ROL KYÇ NË PARANDALIMIN E DHUNËS

Mekanizmat e tillë u ngritën për here të parë në Shqipëri, në 10 bashki në periudhën nga 2007- 2013, në sajë të mbështetjes financiare të UN Trust Fund, (Fondi i Mirëbesimit të Kombeve të Bashkuara) të dy projekteve të njëpasnjëshme, të menaxhuara nga Refleksione dhe të zbatuara nga Rrjeti Kombëtar kundër Dhunës me bazë Gjinore dhe Trafikimit,³ në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 334/2011

MKR përbëhet nga tre struktura, në bashkëpunim dhe koordinim me njëra - tjetrën:

(i) Komiteti Drejtues, (KD) që drejtohet nga Kryetari i Bashkisë dhe ku marrin pjesë titullarët e institucioneve qëndore në nivel lokal si ai Policisë, Gjykatës, Prokurorisë, Përmbarrimit, Drejtorive të Shëndetësisë, Arsimit, Punësimit, Departamenteve të Ndihmës Ekonomike, Sociale dhe Strehimit; (ii) Ekipi Teknik shumë palësh, i përbërë nga përfaqësues të institucioneve lokale të sipërpërmendura, të emëruar nga titullari i institucionit, anëtar i KD; (iii) Koordinatorja Lokale për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, pjesë e punonjësve të emëruar të Bashkive, që drejton dhe koordinon punën në terren të Ekipeve Teknik shumë palësh për t'iu përgjigjur rasteve të Dhunës në familje (DHF) dhe DHKGV.

Kur një rast dhune raportohet apo denoncohet në Polici, Bashki ose nga shërbimet shëndetësore, atëherë gjithë MKR vihet në lëvizje, bashkëpunon, koordinon punën për të mbështetur rastin, parandaluar dhunën ose ofruar shërbimet e mbështetjes ligjore dhe shërbimeve të

3 Rrjeti Kombëtar kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe Trafikimit përbëhet nga pesë organizata të shoqërisë civile: Refleksione, Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", Linja Këshillimore për Gra dhe Vajza, Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare dhe Strehëza për Gra të Dhunuara.

tjera për ta nxjerë rastin nga rrethi vicioz i dhunës. MKR është dera kryesore ku duhet të trokasin gratë dhe vajzat për të marrë mbështetje si për parandalimin e dhunës ndaj tyre ashtu edhe për shërbimet mbështetëse që pushteti lokal përmes këtij Mekanizmi vë në dispozicion të tyre.

Njohja dhe trenimi i anëtarëve të Ekipeve Teknike shumë palëshe të institucioneve lokale, përgjegjëse për të zbatuar ligjin, sidomos të Policisë dhe Gjykatave, ka rëndësi në efikasitetin e veprimeve të MKR dhe është në fokus të ndërhyrjes së Refleksioneve në projektin "Parandalim i dhunës ndaj grave para se ajo të ndodhë"

Refleksionet ju bëjnë thirrje grave dhe vajzave t'u drejtohen MKR, koordinatorëve në bashki për barazinë gjinore dhe kundër dhunës për çdo shqetësim dhe problem që lidhet me dhunën kundër tyre, të flasin hapur dhe pa frikë. Ato do të marrin këshilla, zgjidhje ligjore dhe mbështetje në të gjitha drejtimet.⁴

ROLI I SHOQËRISË CIVILE

MKR për adresimin e rasteve të dhunës në nivel lokal bashkëpunon me organizatat e shoqërisë civile, aktivistë për të drejtat e gruas dhe të njeriut në organizimin e aktiviteteve dhe marrjen e masave për parandalimin e DHKGV para se ajo të ndodhë si edhe në dhënien e shërbimeve, të parashikuara në ligjet përkatëse.

Roli i organizatave të shoqërisë civile në parandalimin e DHKGV, veçanërisht i organizatave të grave, është i rëndësishëm në ndërgjegjësimin për zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe dispozitave

4 Në Annex 1 janë emrat dhe numrat e telefonave të koordinatorëve lokale për barazinë gjinore dhe kundër dhunës ndaj grave në sejcilën nga 12 bashkitë ku Refleksione zbaton projektin, "Parandalim i Dhunës ndaj Grave para se ajo të ndodhë" mbështetur nga Ambasada Gjermane, Tiranë.

të Konventave Ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

Shoqëria civile është një partner i rëndësishëm në Parandalimin Parësor të DHKGV i institucioneve qendrore dhe atyre lokale të angazhuara në këtë fushë . Me ekspertizën, njohjen e situatës në terren dhe kontaktet e shumta shoqëria civile ka kapacitete për të kontribuar në:

1. Rritje e ndërgjegjësimit, në komunitete urbane dhe rurale për kuadrin ligjor kombëtar dhe Konventat Ndërkombëtare, ofrim i trejtimeve për sensibilizim gjinor për institucionet përgjegjëse në zbatimin e ligjeve, përfshirë policinë dhe gjyqësorit.
2. Zhvillim konsultimesh në komunitete për të informuar hartuesit e politikave për barazi gjinore dhe parandalim të dhunës për mendimin nga terreni të qytetarëve si edhe për rritjen e ndërgjegjësimit të komuniteteve për rëndësinë e ligjeve dhe të kuptuarit e të drejtave të gruas si të drejta themelore të njeriut.
3. Mbështetje për mbledhjen e të dhënave me cilësi të lartë lidhur me DHKGV si një mjet thelbësor për advokim dhe përmirësim të punës së institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe adresimin e rasteve të dhunës, kur ato ndodhin.
4. Advokim për ngritjen e departamenteve, agjensive dhe njësive të specializuara në strukturat e qeverisë qendrore dhe asaj lokale si edhe të strukturave të pavarura nga shteti në bazë të legjislacionit për të koordinuar zbatimin e strategjive kombëtare për parandalimin e dhunës ndaj grave vajzave para se ajo të ndodhë.
5. Mbështetje qeverisë për të reformuar kuadrin ligjor dhe politikat lidhur me barazinë gjinore; hartuar, zbatuar dhe monitoruar Strategjitë Kombëtare për barazi gjinore dhe Planin Kombëtar të Veprimit me anë të ekspertizës së shoqërisë civile, rrjeteve të saj kombëtare, rajonale dhe europiane.

ROLI I MEDIAS

Dhuna ndaj grave dhe vajzave dhe parandalimi i saj, para se ajo të ndodhë, janë çështje legjitime të interesit të publikut. Prandaj media luan një rol kyç në Parandalimin Parësor të dhunës kundër grave dhe vajzave. Media ka fuqinë të ndikojë në bindjet, qëndrimet dhe sjelljet individuale dhe ato të shoqërisë. Ndikimi i saj është i drejtëpërdrejtë tek individë ose i tërthortë tek publiku. Në ndikimin individual raportimet dhe informacionet e medias për normat e reja sociale mund t'i bindin individët t'i pranojnë ato. Kurse në ndikimin tek publiku informacionet që jep media mund të krijojnë një njohuri të përbashkët të normave të reja sociale dhe të përforcojnë koordinimim shoqëror të individëve, të cilët bëhen më të gatshëm t'i pranojnë këto norma kur besojnë që edhe të tjerët i kanë pranuar.

Informacionet e medias, sidomos lajmet ndikojnë në mënyrë vendimtare në formimin e opinionin publik lidhur me perceptimin e tij ndaj dhunës dhe rrënjëve të saj. Ndërkohë informacioni në media është një tregues i rëndësishëm përmes të cilit mund të matet përparimi drejt ndryshimit të normave sociale dhe kulturore që sfidojnë dukurinë e dhunës ndaj grave dhe vajzave në shoqërinë tonë.

Raportimet për rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave kontribuojnë në ndryshimin e qëndrimeve që legjitimojnë dhunën dhe ngritjen e vetëdijes publike për “zero” tolerancë ndaj dhunës.

Por lidhja mes dhunës ndaj grave dhe vajzave me pabarazinë gjinore shpesh mungon në raportimet e medias për rastet e dhunës . Për fat të keq shpesh raportimet në media përkrahin stereotipe gjinore dhe në mënyrë të tërthortë e justifikojnë dhunën ndaj grave dhe vajzave, madje për dhunën e ushtruar fajësojnë jo autorët e dhunës por viktimat e tyre.

Nga vëzhgimi i situatës së medias lokale në kuadër të projektit “Parandalim i Dhunës ndaj Grave para se ajo të ndodhë,” të kryer nga CEMT, organizata partnere me “Refleksione” në zbatimin e këtij projekti, rezulton prania e gadishmërisë së gazetarëve lokalë për t’u përfshirë në raportimin e rasteve të dhunës. Ndërkohë që rezultojnë edhe mangësi lidhur me njohuritë e gazetarëve lokale për rolin e tyre në formimin e opinionit publik dhe promovimin e mirëkuptimit të publikut se dhuna është e papranishme dhe ndaj saj duhet të ketë një tolerancë “zero”.

Të dhënat e vëzhgimit tregojnë që media lokale priret më shumë të raportojë për histori të bujshme dhe patur sa më shumë klikime në median sociale ose shitje gazetash, duke u bërë kështu pa dashje bashkëpunuese me një narrativë që nxit dhunën ndaj grave dhe vajzave, duke justifikuar dhe legjitimuar sjellje që nuk konsiderohen si sulme ndaj dinjitetit njerëzor. Një raportim i tillë i rasteve të dhunës krijon frikë e terror tek viktimat / të mbijetuarat që hezitojnë apo nuk guxojnë ta denoncojnë dhunën e ushtruar ndaj tyre. Kjo shfaqet sidomos në rastet e dhunës seksuale dhe qarkullimit të videove që kërcënojnë viktimën duke e futur atë në një qark vijues dhune seksuale. Të dhënat e vëzhgimit nga CEMT tregojnë se media raporton më shumë raste individuale dhune sesa adreson rrënjët dhe pasojat e saj..

Projekti “Parandalim i dhunës ndaj grave para se ajo të ndodhë” merr përsipër të zhvillojë trainime me gazetarët lokalë në 12 bashkitë ku ky projekt zbatohet, për të rritur njohuritë e gazetarëve lokalë dhe vetëdijen e tyre për rolin e rëndësishëm të medias në raportimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në një mënyrë jo-stereotipe, larg të përshkruarit të dhunës si “krim pasioni”. Rritja e njohurive të gazetarëve lokalë pritet të pasqyrohet në ndryshimin e mënyrës së shkrimeve dhe raportimeve për rastet e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe në trajtimin e temës së barazisë gjinore në përgjithësi. Aftësimi i tyre synon që raportimet për rastet e dhunës të shmangin

stereotipet dhe të ndryshojnë mënyrën e raportimit që justifikon dhunën apo minimizon pasojat e saj.

FEJA – ALEAT I RËNDËSISHËM

Feja është një realitet individual dhe institucional në jetën e shoqërisë së Shqipërisë, ku bashkëjetojnë në paqe dhe harmoni feja e krishterë, myslimane dhe ajo bektashiane. Me anë të doktrinave dhe teksteve fetare, feja përçon tek komunitetet e besimtarëve vlerat morale të mos përdorimit të dhunës ndaj grave dhe vajzave.

Liderët e komuniteteve fetare luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e besimtarëve me qëndrime dhe praktika jo të dhunshme. Ata kanë një rol kyç në promovimin e barazisë gjinore dhe Parandalimin Parësor të dhunës ndaj grave dhe vajzave. Ndryshimi i mentalitetit, që është në qëndër të Parandalimit Parësor të dhunës, kërkon që ligjërimi, brenda besimit fetar për të promovuar barazinë gjinore, të përmbajë mesazhe për çmontimin e strukturave dhe praktikave që justifikojnë dhunën dhe pabarazinë gjinore. Liderët e komuniteteve fetare kontribuojnë përmes shërbesave fetare dhe takimeve me komunitetet e tyre në përshpejtimin e ndryshimit të mentalitetit dhe stereotipeve gjinore që ushqejnë dhunën ndaj grave dhe vajzave. Ata kanë një rol potencialisht transformues në komunitetet besimtarëve.

Drejtuesit fetarë janë aleatë në nismat e shoqërisë civile për të çuar përpara barazinë gjinore dhe patur rezultate domethënëse në reduktimin dhe eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave. Kur traditat patriarkale dhe praktikat kulturore justifikojnë diskriminimin ndaj grave, interpretimi i vërtetë i fesë ka fuqinë për të thyer pengesat dhe zhblokuar potencialin njerëzor për të patur një tolerance “zero” ndaj dhunës.

PËRKUFIZIME

Gjinia

Gjinia përdoret për të treguar identitetet, sjelljet dhe praktikat që lidhen me të qënurit vajzë / grua ose djalë / burrë. Gjinia është një koncept i ndryshëm nga seksi, pasi i referohet karakteristikave fizike dhe biologjike të një personi. Eliminimi i diskriminimit në bazë të gjinisë është parakusht për një shoqëri më të barabartë dhe një faktor shumë i rëndësishëm në parandalimin e të gjitha formave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Stereotipet gjinore

Stereotipe Gjinore janë pikpamje, këndvështrime ose paragjykime të përgjithësuara lidhur me tipare, karakteristika, veti dhe role që duhen të kenë apo luajnë në shoqëri gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë.

Norma gjinore dhe sociale

Normat gjinore dhe sociale përcaktojnë veprime të pranueshme dhe të përshtatshme për gratë dhe burrat në një grup ose shoqëri të caktuar. Ato janë të ngulitura në institucione formale dhe joformale, të vendosura në mendjen e njerëzve dhe që prodhohen dhe riprodhohen përmes bashkëveprimit shoqëror.

Rolet gjinore

Rolet gjinore në shoqëri lidhen me pritshmëritë se si duhet të veprojmë, të flasim, të vishemi, të sillemi në bazë të përkatësisë gjinore dhe seksit, të qenit femër apo mashkull. Rolet gjinore ndikojnë në një gamë të gjerë të sjelljes njerëzore, që nga veshja që një person zgjedh, profesionin që ndjek, marrëdhëniet personale që ndërton.

Organizata Botërore e Shëndetësisë i përcakton rolet gjinore si “role, sjellje, veprimtari dhe attribute në marrdhëniet shoqërore, që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për burrat dhe gratë”

Barazia gjinore

Barazia gjinore është parakusht për një shoqëri ku pjesëtarët e saj janë të barabartë dhe një faktor shumë i rëndësishëm për sukses në parandalimin e të gjitha formave të DHF dhe DHKGV. Barazia gjinore ka të bëjë me të drejta, përgjegjësi dhe mundësi të barabarta të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve pavarësisht orientimit të tyre seksual. Ajo mbështetet në konceptin se të gjitha qëniet njerëzore, pa dallim nga identiteti i tyre gjinor, janë të barabarta në dinjitet dhe të drejta; janë të lira për të zhvilluar aftësitë e tyre personale, ndjekur karrierën profesionale, bërë zgjedhje pa diskriminim dhe kufizime të vendosura nga stereotipe, paragjykime dhe role të ngurta gjinore.

Pabarazia gjinore

Pabarazia gjinore ka të bëjë me normat dhe rolet gjinore, praktikat kulturore dhe politikat, ligjet dhe faktorët ekonomikë, praktikat institucionale që të gjitha së bashku kontribuojnë për të përjetësuar marrëdhënie të pabarabarta mes grave dhe burrave në raport me pushtetin. Kjo pabarazi në mënyrë disproporcinale i pengon dhe dëmton gratë të zënë vendin që u takon në shoqëri dhe gjithë fushat e jetë. Pabarazia gjinore rezulton në shpërndarje të pabarabartë të pushtetit, burimeve, mundësive dhe aftësive, pasi burrave u është dhënë më shumë se grave për shkak të normave dhe strukturave diskriminuese gjinore. Pabarazia gjinore është në të njëjtën kohë shkak dhe rezultat i dhunës së burrave ndaj grave.

Dhuna në familje

DHF mund të përshkruhet si pushtet i keqpërdorur nga një i person i rritur për të kontrolluar një person tjetër në marrëdhëniet familiare. Përmes saj dhe formave të tjera të abuzimit synohet vendosja e kontrollit dhe frikësimit në një marrëdhënie familiare. DHF mund të jetë sulm fizik, abuzim psikologjik, social, financiar dhe seksual. Ajo kryhet nga burra dhe gra, por në shumicën e rasteve viktimat e saj janë gra. DHF është forma më e përhapur e dhunës ndaj grave, që ndikon tek gratë gjatë tërë jetës së tyre dhe ka pasoja të rënda për viktimat e saj dhe shoqërinë në tërësi.

Dhuna kundër grave dhe vajzave

Dhuna ndaj grave dhe vajzave (DHKGV) është një shkelje e të drejtave themelore të njeriut që ndodh për shkak të gjinisë dhe ushtrohet nga burrat si një mjet për të ushtruar fuqi dhe kontroll mbi gratë. Sipas përkufizimit të Oganizatës së Kombeve të Bashkuara, DHKGV ka të bëjë me “çdo veprim të dhunës me bazë gjinore që rezulton të ketë shkaktuar ose mund të shkaktojë tek gratë dhe vajzat dëm fizik, seksual ose psikologjik ose vuajtje duke përfshirë edhe kërcënime apo veprime të tilla si presioni, privimi arbitrar i lirisë në jetën publike apo private.” DHKGV është e rrënjosur përmes diskriminimit me bazë gjinore, normave sociale dhe stereotipeve gjinore. Mënyra më e mirë për t'i dhënë fund kësaj dhune është parandalimi duke adresuar shkaqet e saj.





